



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 663, datë 02.11.2023

**PËR
DEKLARIMIN E PËRFUNDUAR, PA NJË VENDIM PËRFUNDIMTAR, TË
SHQYRTIMIT TË KËRKESËS SË ZNJ. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 02.11.2023, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe projektvendimin “Mbi deklarin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesës së znj. {...}”, përgatitur nga relatori z. Klodian Kurushi, si dhe pasi shqyrtoi propozimin përkatës,

VËREN

I. Rrethanat e faktit

1. Znj. {...} , ka qenë në pozicionin e këshilltares ligjore (ndihmëse ligjore) në Gjykatën e Lartë. Ajo ka filluar marrëdhënien e punës pranë Gjykatës së Lartë në datën 07.04.2014. Me Urdhrin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, me nr. 252, datë 06.10.2017 “Për lirimin nga detyra”, është vendosur: *“Lirimin e znj. {...} nga detyra e ndihmëses ligjore, pasi ka përfunduar afati i kontratës së punës, me mbarimin e mandatit të anëtarit të Gjykatës së Lartë, z. Andi Çeliku, pranë të cilit ka punuar si ndihmëse ligjore.”*
2. Kërkuesja, znj. {...} , në datën 22.02.2019 e në vijim, i është drejtuar me kërkesa Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke i kërkuar rikthimin në pozicionin e punës këshilltare ligjore pranë Gjykatës së Lartë ose vendeve analoge me të. Gjithashtu kërkuesja kishte paraqitur padi edhe në Gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë, padi e cila kishte si kërkim po rikthimin në pozicionin e punës këshilltare.
3. Në këto kushte, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 259, datë 23.07.2020 ka vendosur ndër të tjera: *“1.Pezullimin e shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga znj. {...} , për rikthimin e saj në funksionin e Këshilltarit të Gjykatës së Lartë për shkak se kërkesa është në shqyrtim para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë... ”*

4. Ky vendim erdhi si pasojë e vlerësimit të faktit se kërkimi përpara Këshillit ishte për shqyrtim edhe përpara Gjykatës së Rrethit gjyqësor Tiranë. Pra, ky vendim i ndërmjetëm u konkludua duke mbajtur në konsideratë parashikimin procedural civil, sipas të cilit asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata, të parashikuar në Nenin 36 të Kodit të Procedurës Civile.
5. Këshillit të Lartë Gjyqësor i është komunikuar vendimi nr. 264/86-2022-368, datë 23.06.2022 i Gjykatës Administrative të Apelit me palë paditëse znj. {...} dhe palë të paditura Gjykata e Lartë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.
6. Gjykata Administrative e Apelit me vendimin e sipërcituar ka vendosur:

“1. Ndryshimin e vendimit nr.1779 datë 07.06.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

2. Pranimin e padisë.

3. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrit nr.252, datë 06.10.2017 të Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

4. Kthimin në detyrën e këshilltares ligjore në Gjykatën e Lartë të paditëses {...}.

5. Detyrimin e palës së paditur Gjykata e Lartë për pagimin e pagës për periudhën 14.10.2017 deri në ditën e ekzekutimit të këtij vendimi gjyqësor.

6. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palëve të paditura.

7. Ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet menjëherë nga shërbimi përmbarimor.

8. Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, brenda 30 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi në formë të arsyetuar.

Ky vendim është unanim.

Shpallet sot në Tiranë në datë 23.06.2022.”

7. Znj. {...} në vijim të kërkesave të mëparshme drejtuar Këshillit, me kërkesën nr. 1722/30 prot., datë 07.09.2022 i është drejtuar Këshillit duke kërkuar ekzekutimin e vendimit nr. 264/86-2022-368, datë 23.06.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit.
8. Këshilli, në vijim, me vendimin nr. 455, datë 02.11.2022 në përputhje me nenin 68/2 të Kodit të Procedurave Administrative, ka vendosur: *“1. Shfuqizimin e vendimit nr. 259, datë 23.07.2020 të KLGj-së “Për pezullimin e shqyrtimit të kërkesës për rikthimin në detyrë të znj. {...} .” 2. Vijimin e procedurës së shqyrtimit të kërkesës për rikthimin në detyrë të znj. {...} ”.* Ky vendim u mor në kushtet kur shkaqet e ekzistencës së tij kanë pushuar së ekzistuari.

II. Arsyetimi i Gjykatës Administrative të Apelit

9. Gjykata Administrative e Apelit, në vendimin nr. 264/86-2022-368, datë 23.06.2022 ndër të tjera ka arsyetuar se:

“30. Gjykata Administrative e Apelit vlerëson të evidentojë se, në interpretim dhe zbatim të drejtë të dispozitave kushtetuese dhe ligjore të sipërcituara, këshilltarët ligjorë në

Gjykatën e Lartë përfshihen në kategorinë e nëpunësve civilë gjyqësorë. Pas kryerjes së formimit profesional fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, përzgjedhja dhe emërimi si këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë, sikurse edhe ndjekja e procedurave dhe disponimet e tjera të lidhura me statusin e tyre si nëpunës civilë gjyqësorë, përfshirë edhe përfundimin e këtij statusi, janë kompetencë e KLGJ.

31. Lidhur me këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës së Lartë që ishin në detyrë në kohën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese me ligjin nr.76/2016, si edhe të ligjeve nr.84/2016, nr.96/2016 dhe nr.98/2016, në dispozitat kalimtare të këtyre ligjeve përcaktohet qartë se ata do të vijojnë ushtrimin e funksionit dhe do të qëndrojnë në detyrë me kushtin që të kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar. Pra, krahas parashikimit të qartë të ri ligjor për vazhdimësinë e ushtrimit të funksionit, konfirmimi i qëndrimit të tyre në detyrë në mënyrë të përhershme, edhe si nëpunës civil gjyqësor, përcaktohet vetëm me vendim të formës së prerë të organeve të rivlerësimit kalimtar. Madje, kuadri i ri kushtetues dhe ligjor, jo vetëm që e parashikon vazhdimësinë në detyrë, por parashikon e synon edhe që këta këshilltarë ligjorë, nëse arrijnë rezultatin e përcaktuar sipas ligjit, të emërohen si magjistratë të karrierës, pas ndjekjes dhe përfundimit me sukses të një programi të posaçëm formimi fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës.

32. Në këtë kuptim, për këshilltarët ligjorë në detyrë pranë Gjykatës së Lartë, nuk kishin më asnjë efekt juridik rregullimet e mëparshme ligjore dhe qëndrimet e praktikës gjyqësore, të bazuara në K.Punës dhe në ligjin nr.8588/2000, për qëndrimin e tyre në detyrë me afat të caktuar deri në mbarim të mandatit të gjyqtarit pranë të cilit ushtronin funksionin, sikurse edhe qenia e Kryetarit të Gjykatës së Lartë si përfaqësues dhe ushtrues i kompetencave të palës punëdhënëse.

33. Në çdo rast, deri në dhënien e vendimit të formës së prerë nga organet e rivlerësimit kalimtar për konfirmimin në detyrë, nëse për arsye të tjera të parashikuara nga ligji, por të ndryshme nga ajo e kohëzgjatjes së kontratës së tyre të shërbimit publik, krijohen rrethanat e mbështetura në ligj për zgjidhjen e njëanshme apo konsensuale të kontratës së shërbimit publik me këshilltarët ligjorë, organi kompetent për të disponuar nuk mund të jetë Kryetari i Gjykatës së Lartë. Rregullimet e reja kushtetuese e ligjore dhe ato kalimtare nuk përmbajnë asnjë parashikim që t'i mundësojë Kryetarit të Gjykatës së Lartë, sikurse edhe kryetarëve të gjykatave të tjera, të ushtrojë kompetenca me të cilat të vlerësojë dhe disponojë si për emërimin e këshilltarëve të rinj ligjorë, ashtu edhe për zgjidhjen e kontratës së shërbimit publik me këshilltarët ligjorë në detyrë.

34. Meqenëse, për këshilltarët ligjorë të Gjykatës së Lartë, Kushtetuta dhe ligjet e reja të miratuara përmbajnë rregulla të posaçme mbi statusin e tyre etj., ndryshe nga rasti i nëpunësve dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës, edhe në kushtet e mosfillimit të funksionimit të KLGJ, Kryetari i Gjykatës së Lartë nuk mund të vendoste për karrierën e tyre dhe as për zgjidhjen e njëanshme apo konsensuale të kontratës së shërbimit publik me ta. Madje, nga përmbajtja e dispozitës kalimtare të pikës 2 të nenit 92 të ligjit nr.98/2016 në mënyrë të qartë rezulton se është shfuqizuar, menjëherë dhe pa asnjë rrethanë përjashtimore për ushtrimin e saj, kompetenca e Kryetarit të Gjykatës së Lartë e parashikuar posaçërisht në shkronjën “ç” të nenit 7 të ligjit nr.8588/2000 për emërimin dhe shkarkimin nga detyra të

këshilltarëve ligjorë, ndërkohë duke i lejuar të ushtrojë disa kompetenca të tjera edhe për periudhën kalimtare deri në krijimin e KLGJ.

...36. Por, me Urdhrin nr.252, datë 06.10.2017, Kryetari i Gjykatës së Lartë ka vendosur lirim nga detyra të paditëses {...}, këshilltare ligjore, me motivin se “ka përfunduar afati i kontratës së punës, me mbarimin e mandatit të anëtarit të Gjykatës së Lartë, z. Andi Çeliku, pranë të cilit ka punuar si ndihmëse ligjore.”

37. Nga ana tjetër, rezulton e provuar edhe se, në zbatim të parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës dhe atyre të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në cilësinë e subjektit të rivlerësimit kalimtar, paditësja {...} ka shprehur qartë vullnetin e saj për t’iu nënshtruar këtij procesi.

...40. Me shkresën drejtuar KPK-së në datën 26.09.2019, paditësja {...} ka rikonfirmuar interesin dhe vullnetin e saj për t’iu nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar dhe për të vijuar karrierën e këshilltares ligjorë pranë Gjykatës së Lartë.

41. Së fundi, në shortin e datës 15.06.2021, KPK ka shortuar paditësen {...} në cilësinë e subjektit të procesit të rivlerësimit kalimtar, duke vijuar me procedurat e verifikimit të këtij subjekti. KPK ende nuk është shprehur ka caktuar datën e seancës për tu shprehur në lidhje me këtë subjekt.

...46. Me hyrjen në fuqi të ligjit kushtetues nr.76/2016, si edhe të ligjeve nr.84/2016, nr.96/2016 dhe nr.98/2016, marrëdhënia e shërbimit publik dhe statusi i këshilltarëve ligjorë pranë Gjykatës së Lartë ndryshoi thelbësisht. Këta funksionarë përcaktohet të kenë tashmë statusin e nëpunësit civil gjyqësor, status që gjen rregullim të posaçëm me ligj. Po kështu, ndryshon thelbësisht mënyra e pranimit, emërimit, lëvizjes dhe mbarimit të ushtrimit të këtij funksioni. Tashmë përzgjedhja, emërimi dhe largimi nga detyra i tyre është në kompetencën e KLGJ dhe jo të titullarit të Gjykatës së Lartë, të cilit i është hequr qartësisht një kompetencë e tillë. Nga ana tjetër, legjislacioni i ri përcakton qartë se marrëdhënia e shërbimit publik në funksionin e këshilltarit ligjor pranë Gjykatës së Lartë, sikurse për nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë, është pa afat dhe e pa lidhur me mandatin e gjyqtarëve të asaj Gjykate, duke ndryshuar në thelb nga qenia me afat dhe me kusht në ushtrimin e kësaj detyre në varësi të mbarimit të rregullt a të parakohshëm të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë pranë të cilit ushtronin detyrën.

47. Nga ana tjetër, neni 179/b i Kushtetutës përcakton qartë se këshilltarët ligjorë në Gjykatën e Lartë janë subjekte të rivlerësimit kalimtar. Pra, për të vijuar ushtrimin e funksionit përkatës, ashtu sikurse gjyqtarët dhe prokurorët, edhe këta funksionarë publikë duhet ti nënshtrohen procesit të verifikimit të integritetit të tyre pasuror, moral dhe aftësisë profesionale, për të cilat, sipas Kushtetutës dhe ligjit, veprojnë dhe disponojnë organet e rivlerësimit kalimtar. 48. Për këtë arsye, në pikën 4 të nenit 84 të ligjit nr.98/2016 parashikohet se këta këshilltarë ligjorë janë subjekt i dispozitave kalimtare të ligjit nr.96/2016 mbi statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Pikërisht, për të njëjtën arsye, ky ligj (nr.96/2016), në nenin 165 të tij, duke përsëritur parashikimin kushtetues se janë subjekte të procesit të rivlerësimit kalimtar (pika 1), **gjithashtu parashikon se këta këshilltarë ligjorë do të vazhdojnë të qëndrojnë në detyrë, pra pavarësisht nëse mbaron apo jo afati i kontratës së tyre të shërbimit publik, me kushtin që të kalojnë me sukses**

procesin e rivlerësimit kalimtar apo që kjo marrëdhënie shërbimi publik të mos përfundojë për arsye të tjera ligjore (pika 2). Këto arsye të tjera ligjore sigurisht nuk lidhen me kohëzgjatjen e kontratës me afat të ushtrimit të detyrës sepse vetë ligji përcakton shprehimisht që kjo marrëdhënie shërbimi publik do të vazhdojë me kushtin që organet e rivlerësimit kalimtar të konfirmojnë në detyrë këshilltarin ligjor.

...50. Gjithashtu, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se legjislacioni i ri i sipërcituar, i miratuar me ndryshimet kushtetuese dhe ligjore të vitit 2016 dhe 2017, ka parashikuar qartë se, në lidhje me statusin e nëpunësve civilë gjyqësor me funksion këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë, i vetmi organ kompetent që disponon është KLGJ. Ndërkohë, sipas dispozitave kalimtare të nenit 179/b të Kushtetutës, dispozitave të ligjit nr.84/2016, si edhe atyre kalimtare të ligjeve nr.96/2016 dhe nr.98/2016 të sipërcituara, për këshilltarët ligjorë në detyrë në kohën e hyrjes në fuqi të këtyre dispozitave, janë organet e rivlerësimit kalimtar që, në përfundim të procedurave të rivlerësimit, disponojnë me vendim për vazhdimin ose jo të ushtrimit të këtij funksioni. 51. Kompetenca e mëparshme e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, e parashikuar nga shkronja “ç” e nenit 7 të ligjit nr.8588/2000, është shfuqizuar menjëherë me hyrjen në fuqi të ligjit nr.98/2016 (neni 92 pika 2), pa lejuar asnjë rast përjashtimor për ushtrimin e kësaj kompetence prej tij gjatë periudhës kalimtare deri në fillimin e veprimtarisë së KLGJ dhe deri në përfundim të veprimtarisë së organeve të rivlerësimit kalimtar.

...54. Urdhri nr.252, datë 06.10.2017, i Kryetarit të Gjykatës së Lartë me të cilin ka vendosur lirimin nga detyra të paditëses {...} , si këshilltare ligjore në Gjykatën e Lartë, është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, i nxjerrë në kundërshtim të hapur dhe flagrant me dispozitat urdhëruese kushtetuese dhe ligjore mbi qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e detyrës dhe mbi statusin e garancitë kushtetuese e ligjore të këshilltarëve ligjorë, e në veçanti për mungesën e qartë të kompetencës së Kryetarit të Gjykatës së Lartë për të disponuar për ndërprerjen e shërbimit publik të këshilltarit ligjor, ndërkohë që një kompetencë të tillë e ka pala e paditur KLGJ dhe, në periudhën kalimtare, organet e rivlerësimit kalimtar. Kjo shkelje flagrante e ligjit material e procedural dhe, posaçërisht, mungesa flagrante e kompetencës së Kryetarit të Gjykatës së Lartë për të disponuar largimin nga detyra të këshilltarit ligjor është veçanërisht evidente për sa i përket vazhdimin të qëndrimit të tyre në detyrë deri në përfundim të rivlerësimit kalimtar dhe mbetjes pa fuqi ligjore të rregullave të mëparshme të ushtrimit të këtij funksioni publik me kusht dhe me afat të caktuar deri në mbarim të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë pranë të cilit ushtronte detyrën.”

55. Për këto arsye, Gjykata Administrative e Apelit vjen në përfundimin se duhet të ndryshohet vendimi nr. 1779 (80-2021-1799), datë 07.06.2021, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe të pranohet padia, duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të Urdhrit nr.252, datë 06.10.2017 të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, kthimin e paditëses në detyrën e saj si këshilltare ligjore pranë palës së paditur Gjykata e Lartë, duke i paguar edhe pagën për kohën e qëndrimit pa e ushtruar detyrën deri në ekzekutimin e këtij vendimi.”

III. KONKLUZIONE

10. Vendimi nr. 264/86-2022-368, datë 23.06.2022 i Gjykatës Administrative të Apelit është një vendim i formës së prerë, që përbën titull ekzekutiv.
11. Në kushtet kur çështja gjyqësore ka marrë formë të prerë, është vendi që Këshilli të vijojë/përfundojë procedurën e tij lidhur me kërkesën e znj. {...} .
12. Nga përmbajtja si edhe dispozitivi i vendimit të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, rezulton se nëpërmjet këtij vendimit ka marrë zgjidhje kërkesa e znj. {...} për rikthimin në detyrë si Këshilltare Ligjore në Gjykatën e Lartë. Ky vendim disponon kthimin e paditëses në detyrën e saj si këshilltare ligjore pranë palës së paditur Gjykata e Lartë, duke i paguar edhe pagën për kohën e qëndrimit pa e ushtruar detyrën deri në ekzekutimin e këtij vendimi, duke detyruar palën e paditur Gjykatën e Lartë me ekzekutimin e këtij vendimi. Në këto rrethana kërkesa e znj. Gaçe për rikthimin e saj në pozicionin e këshilltares ligjore në Gjykatën e Lartë, mbetet pa objekt për t'u trajtuar nga Këshilli.
13. Prandaj është vendi që Këshilli të vendosë për deklarimin e përfunduar të kërkesës pa një vendim përfundimtar, bazuar në nenin 90/3 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative, rregullimet e të cilit duhet të zbatohen nga Këshilli në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes si sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, sikurse përcakton neni 97/3 i tij.
- 13.1 Sipas nenit 90/3 të Kodit të Procedurave Administrative, *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”*.
- 13.2 Sipas nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative, *“Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”*.
- 13.3 Sipas nenit 97/3 të Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, *“Këshilli i Lartë Gjyqësor zbaton Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ky ligj”*.
14. Këshilli në këtë rast është i detyruar të deklarojë përfundimin e procedurës pa vendim përfundimtar mbi themelin e çështjes, pasi kërkesa e kërkueses znj. {...} në kushtet kur është zgjidhur nga Gjykata Administrative e Apelit mbetet pa objekt.

PËR KËTO ARSYE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 90/3 e 95 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenet 2, 90 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, pasi shqyrtoi relacionin dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, në përfundim,

VENDOSI:

1. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës së znj. {...} , për rikthimin e saj në pozicionin e këshilltares ligjore në Gjykatën e Lartë, për shkak se kjo kërkesë është zgjidhur nga vendimi nr. 264/86-2022-368, datë 23.06.2022 i Gjykatës Administrative të Apelit.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...} , sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR